


# Nëse keni simptoma të gripit gjatë shtatzënisë

Vaksinimi kundër gripit do të zvogëlojë rrezikun nga sëmundja gjatë shtatzënisë dhe ndihmon për të mbrojtur foshnjën e porsalindur. Mirëpo për shkak se vaksina nuk mbron 100% nga gripin, është e rëndësishme që të kontaktoni mjekun ose maminë që ndjek shtatzëninë nëse vëreni simptoma të ngjashme me gripin, edhe nëse jeni vaksinuar më parë.

Simptomat më të shpeshta janë temperatura, kollitja, dhimbja në muskuj dhe kokëdhimbja. Shumica e njerëzve shërohen shpejt, por disa here gripin mund të shkaktojë komplikime serioze duke përfshirë pneumoni ose bronkit, madje mund të përfundojë edhe me vdekje.



**Vaksinimi është i sigurt**

[www.euro.who.int/en/fluaware](http://www.euro.who.int/en/fluaware)



## GRIPIN MUND TË JETË SERIOZ PER JU DHE PËR FEMIJEN TUAJ GJATË SHTATZANISË

### Vaksinohu !



# Gripi mund të shkaktojë problem serioz gjatë shtatzanisë



Gratë shtatzëna janë më të rrezikuara nga shumë sëmundje serioze dhe hospitalizohen shumë më shpesh për shkak të gripit në krahasim me personat e tjerë të shëndetshëm. Kjo ndodh sepse ndryshimet e përkohshme në sistemin imunitar, në zemër dhe në mushkëri i bëjnë gratë shtatzëna më të prirura ndaj sëmundjeve të rënda.

Gripi mund të shkaktojë probleme serioze tek foshnjat e porsalindura, për arsye se sistemi imunitar i tyre ende nuk është zhvilluar plotësisht e prandaj nuk mund të luftojë infeksionet. Së fundi, gripi gjatë shtatzënisë mund të shkaktojë lindje të parakohshme ose foshnja të lindë me peshë më të vogël.

## Cfarë është gripi ?

Gripi është një sëmundje ngjitëse që përhapet nga personi në person kryesisht përmes kollitjes, teshtimës dhe kontaktit të afërt. Epidemitë e gripit zakonisht ndodhin në dimër. Simptomat e influencës fillojnë papritur dhe mund të zgjasin nga disa ditë deri në dy javë. Simptomat e zakonshëm përfshijnë ethe, kollë, dhimbje të trupit dhe dhimbje koke. Shumica e njerëzve shërohen shpejtë, por, ndonjëherë, gripi mund të shkaktojë komplikime serioze, si pneumonia, bronkiti, madje edhe vdekja.

## Vaksinimi sezonal kundër gripit – zgjidhja më e mirë gjatë shtatzënisë për nënën dhe fëmijën

Vaksinimi sezonal i gripit është i sigurt në të gjitha fazat e shtatzënisë. Miliona doza të vaksinës sezonale të gripit janë dhënë për gratë shtatzëna në të gjithë botën për shumë vite dhe vaksina është e sigurt gjatë shtatzënisë.

Sapo të jeni vaksinuar, ju e përcillni imunitetin tuaj tek foshnja, duke e mbrojtur në këtë mënyrë foshnjën tuaj për gjashtë muajt e parë të jetës. Kjo është e rëndësishme sepse fëmijët nën gjashtë muaj janë shumë të rinj për të marrë vaksinën.

Efektet anësore të zakonshme të vaksinimit përfshijnë dhimbje dhe skuqje në vendin e injektimit. Disa njerëz përjetojnë dhimbje koke, dhimbje në muskuj, ethe, lodhje dhe neveri. Këto efekte anësore janë të lehtë dhe kalojnë më shpejt për dallim nga vetë sëmundja e gripit.